



1070/2

UDHËZIM PLOTËSUES

21.8.2020

Nr. 2/1, datë 21.8.2020

“PËR

**NJË SHITESË NË UDHËZIMIN PLOTËSUES NR. 2, DATË 20.01.2020 ‘PËR ZBATIMIN E BUXHETIT TË VITIT 2020’, TË NDRYSHUAR”**

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102 të Kushtetutës, në zbatim të nenit 38 të ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008, “Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, nenit 21, të ligjit 88/2019, “Për Buxhetin e vitit 2020” dhe në vijim të Udhëzimit të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr. 9, datë 20.03.2018, “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, paragrafi 2,

**UDHËZOJ:**

Në Udhëzimin Plotësues nr. 2, datë 20.01.2020 “Për zbatimin e Buxhetit të vitit 2020”, në kreun I. “Procedura specifike shtesë për zbatimin e Buxhetit të Shtetit” bëhet ndryshimi si më poshtë:

1. Në pikën 76, shtohet gërma “I”, me këtë përmbajtje:

“I”. Fondet e akorduara nga Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit të Transportit Rrugor për llogari të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve të cilat do të përdoren për kryerjen e pagesave të ndihmës financiare në zbatim të VKM-së nr. 651, datë 13.8.2020 “Për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe të masës së përfitimit të ndihmës financiare, si pasojë e COVID-19, për të punësuarit apo ish-të punësuarit në subjektet e transportit publik, qytetas dhe ndërqytetas”.

2. Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë.

MINISTËR

Anila Denaj

